



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 255/26 Dt. 23.06.2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Beledijesi

ZYRA E KRYETARIT

DATË:	23. 06. 2026
PËR:	Vlora Mehmeti-Spanca, Auditore e Përgjithëshme
CC:	Lavdim Maxhuni, Drejtor i Departamentit për Auditim Financiar dhe Pajtueshmërisë Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit të auditimit
NGA:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
LËNDA:	PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025

Të nderuar,

Në pajtim me nenin 14, pika 1 deri në 7 të Rregullorës së punës për zbatimin e Auditimit dhe Planeve të veprimit të Zyres Kombëtare të Auditimit, gjeni të bashkangjitur Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve nga Raporti Final i Auditimit për Komunën e Prizrenit për vitin financiar të përfunduar me 31.12.2025, të përgatitur nga anëtarët e grupit punues në bashkëpunim me NjAB.

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT
FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025**

Nr	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	Kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,148,191€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas urdhrave përmbarimor të gjykatës për zbatimin e kontratës kolektive nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 1,419,064€, dhe nga investime kapitale 729,127€.	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që, me rastin e përgatitjes së buxhetit të merr parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të MFPT, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.	Pagesat për paga jubilarë dhe shujtat kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive jashtë vullnetit dhe mundësisë së planifikimit nga komuna. Siç jeni në dijeni, pavarësisht faktit se në Ligjin për Buxhetin është paraparë fondi rezerv nga i cili është planifikuar të mbulohen pagesat eventuale përmbarimore, në praktikë nuk ka ekzistuar mundësia teknike dhe procedurale që këto pagesa të realizohen nga ky fond. Konkretisht, për çdo pagesë të ardhur për ekzekutim nga Thesari do të ishte i nevojshëm miratimi paraprak përmes vendimit të Kuvendit Komunal për bartjen e mjeteve, gjë që është praktikisht e pamundur të organizohet dhe të realizohet brenda afateve të ekzekutimit të pagesave, prandaj një gjë e tillë është proceduralisht dhe teknikisht e pamundur të zbatohet edhe gjatë vitit 2026. Adresimi në vazhdimësi i çështjes tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe ministrinë përkatëse, me kërkesë që obligimet që rrjedhin nga kontrata kolektive (shujta, inflacioni, pagat jubilarë dhe detyrime të ngjashme) të lejohen tavanet buxhetore për planifikim në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve.	Zyrtari kryesor financiar, Drejtorët e Drejtorive përkatëse	Zbatimi i këtij rekomandimi nuk mund të realizohet brenda vitit 2026, pasi paraqet proces të vazhdueshëm dhe afatgjatë.
2	Çështja B2 - Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme	Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në nenin 16 në Raportin Vjetor Financiar (RVF) në vlerë 29,277,478€, ishin të nënvlerësuara për 355,098€, pasi që drejtoria e urbanizimit nuk i kishte raportuar saktë llogaritë e arkëtueshme nga lejet e ndërtimit.	Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim të përmirësimit të procesit të menaxhimit dhe raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në RVF.	Korrigjim i të dhënave në regjistrin ekzistues (Excel); Verifikim dhe përditësim periodik i pagesave të arkëtuara me regjistrin ekzistues(exel) të drejtorisë.	Zyrtari/ja përgjegjës në DUPH që janë të ngarkuar me lëshimin e pagesave për leje ndërtimore.	31.12.2026

3	Çështja B3 - Mos raportimi i pasurive jo financiare në PFV dhe mos mbyllja e investimeve në vijim	Në auditimin e pasurive jo financiare kemi identifikuar se, shtatë (7) pagesa në vlerë 839,226€ që ishin në fazën e investimeve në vijim dhe ende nuk ishin përfunduar, nuk ishin prezentuar, raportuar tek Raporti Vjetor Financiar (RFV), duke rezultuar në nënvlerësimin të pasurive Këto pasuri ishin për investime kapitale në infrastrukturën publike. Gjithashtu duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se akoma ka të regjistruara pasuri në kategorinë investime në vijim për vitet 2013 deri në vitin 2023 në vlerë totale 47,270,834€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim akoma mbahen në regjistra si pasuri në vijim.	Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e pasurive, ashtu që pasuritë të raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.	I njëjti problem është evidentuar edhe gjatë viteve 2024 dhe 2025, ku disa pagesa të regjistruara në sistem nuk paraqiten në pasqyrat financiare. Për këtë çështje gjatë procesit të auditimit të jashtëm, ju janë ofruar sqarime të detajuara. Si zyrtare e pasurisë, veproj në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e përcaktuara nga Thesari. Gjatë vitit raportues, rreth 500,000 € kanë qenë donacione të regjistruara me kodin ekonomik 61, të cilat, sipas udhëzimeve dhe konfigurimit të sistemit të Thesarit në MEF, nuk paraqiten në pasqyrat financiare. Meqenëse kjo çështje është përsëritur në më shumë se një periudhë raportuese, konsiderojmë se zgjidhja e saj kërkon koordinim dhe trajtim nga Thesari dhe Zyra Kombëtare e Auditimit, me qëllim të eliminimit të kësaj problematike në raportimet e ardhshme financiare. Kryetari ka formuar një grup punues i cili është angazhuar për mbylljen e investimeve të përfunduara në regjistrin e pasurisë. Ky grup punues, në vazhdimësi është duke kompletuar dokumentacionin e nevojshëm për mbylljen e investimeve në vijim.	Zyrtari i pasurisë Anëtarët e grupit punues, zyrtari i pasurisë.	Sa i përket raportimit në regjistrat e pasurisë, veprimet do të përmbyllen sipas afatit të përcaktuar 09.01.2027 E gjetura/rekomandimi lidhur me mosmbylljen e investimeve në vijim nuk mund të zbatohet në tërësi brenda vitit 2026, pasi procesi do të vazhdojë deri në përmbylljen e të gjitha investimeve të pambyllura që nga viti 2013.
4	Çështja A1 - Mos përputhjes të sasive të realizuara sipas çmimit për njësi të peshuar dhe sasisë së realizuar	Tek kontrata publike kornizë me çmim njësi "Mirëmbajtja dhe mbjellja e druve dekorative në komunën e Prizrenit" me vlerë të parashikuar 210,000€, kemi vërejtur se ka mos përputhje sipas pozicioneve të dhëna në bazë të peshimit dhe realizimit të punimeve. Te kategoria e I që përfshin "Tre pozicione, 1. Prerja e asfaltit, 2. Prerja e drunjeve ekzistues dhe 3 Furnizimi dhe montimi i anësorëve" ishte peshuar 20% apo 42,000€ e vlerës së parashikuar, ndërsa ishte realizuar vetëm 7,681€, kategoria e II që përfshin 36 pozicione "Furnizimin dhe mbjellja e llojeve të ndryshme të drunjëve dhe tjera" ishte peshuar me 50% apo 105,000€ derisa ishte shpenzuar 196,980€ apo 96% e vlerës së parashikuar, dhe Kategoria e III që përfshin " Tre pozicione për rregullimin e konstruksionit nga metali tri modele" ishte peshuar me 30% apo 63,000€ ndërsa ishte vetëm 649€. Kjo kontratë ishte realizuar në shumë prej 205,311€, ndonëse kontrata në total nuk është tejkaluar por kjo ka ndikuar në mos arritjen e qëllimit të planifikimit dhe kontraktimit gjatë realizimit për këto punë; dhe Në kontratën publike kornizë me çmim njësi "Hartimi i projektit për kolektorët kryesor të qytetit të Prizrenit" me vlerë të parashikuar 100,000€, pozicioni i pestë (V) që përfshin "Studimi i fizibilitetit dhe detalimi i projektit për kanalizimet e reja të cilat nuk kanë qenë të përfshira në studimet paraprake". ishte peshuar me 5% të vlerës së kontratës që i lejohet të shpenzohet në vlerë 5,000€, ndërsa ishte tejkaluar duke u realizuar 85,094€ apo 85% e vlerës së kontratës gjatë realizimit.	Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë përmes njësie kërkuese, të bëhet një vlerësim i saktë i nevojave reale të komunës gjatë përgatitjes së kërkesave për tender dhe peshat e specifikuara në dosjet e tenderit të reflektojnë rëndësinë dhe vëllimin e pritshëm të shërbimeve që do të kryhen në praktikë. Gjatë zbatimit të kontratës, menaxherët e kontratave të monitorojnë zbatimin sipas peshave të miratuara, për të garantuar përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe objektivat buxhetore.	Tek e gjetura,, Mirëmbajtja dhe mbjellja e druve dekorative në komunën e Prizrenit" ka skaduar kontrata dhe në të ardhmen do të merret parasysh mos të përsëriten gabimet. Kontratat e natyrës së këtij aktiviteti do të analizohen në përpikmëri; Tek kontrata "Hartimi i projektit për kolektorët kryesor të qytetit të Prizrenit" ka ndodhur një gabim teknik tek situacioni. Pozicionet tjera (me peshë ma te madhe) janë të realizuara shërbimet dhe janë të dokumentuara porse gjatë faturimit ka ndodh gabim.Me fjalë tjera të gjitha pozicionet në bazë të kontratës janë realizuar. Menaxhmenti i njësisë kërkuese dhe menaxherët e kontratave, kan filluar zbatimin e rekomandimit për kontrata e ngjashme në të ardhmen, duke forcuar procesin e planifikimit të nevojave dhe monitorimit të kontratave. Gjatë përgatitjes së kërkesave për tender do të bëhet vlerësim më i saktë i nevojave reale, në mënyrë që peshat e përcaktuara në paramasa të reflektojnë sa më saktë vëllimin e pritshëm të punimeve dhe shërbimeve.	Menaxherët e kontratave /ekipi menaxhues Njësia kërkuese, i kontratave	31.12.2026

5	Çështja A2 - Mos respektimi i kushteve të pagesës sipas kësteve për leje ndërtimit	Kemi identifikuar në katër raste (4) të lëshimit të lejeve ndërtimore komuna ju kishte mundësuar aplikuesve që pagesën ta kryejnë me këste, mirëpo kjo nuk është respektuar nga ana e tyre dhe nuk ju kanë përmbajtur kushteve të marrëveshjes. Më tutje nuk ishin marrë veprimet nga ana e zyrtarëve përgjegjës që obligimet të kryhen.	Rekomandimi A2 Kryetari i komunës duhet të sigurojë se do të ndërmerr veprimet ligjore dhe administrative për të gjithë ata atë cilët nuk kanë përmbushur obligimet e tyre me kohë dhe të veprime, duke ndërmarrë hapa/mekanizma ligjor për arkëtimin e të arketueshmeve.	Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor (DUPH) ka ndërmarrë veprime konkrete për adresimin e çështjes së mosrespektimit të kushteve të pagesës sipas kësteve për lejet ndërtimore. Në këtë drejtim, me vendim të Kuvendit të Komunës së Prizrenit Nr. 001/011-38209, datë 30.03.2026, është shfuqizuar Vendimi Nr. 001/011-60689, datë 02.07.2020, i cili rregullonte mënyrën e pagesës së taksës administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.	Drejtori i DUPH, zyrtarët përgjegjës për procedurat e dhënjes së lejeve ndërtimore	Zbatimi i rekomandimit ka filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 001/011-38209.
6	Çështja A3 - Mospërdorimi i procedurës së duhur të prokurimit	Te kontrata "Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave në zonën e parë të objekteve të mbrojtura, kryesisht në pjesën e vjetër të qytetit të Prizrenit" me çmim për njësi 5,978.10€, dhe me vlerë të parashikuar 3,000,000€, gabimisht kishte përdorur llojin e kontratës publike kornizë çmim për njësi për punë. Kontrata publike kornizë me çmime për njësi mund të udhëhiqen vetëm për llojet e kontratave për furnizime dhe shërbime, por jo edhe për punë, që me rastin e projektimit për punë të planifikohen sasi të paramasës dhe parallogarisë në bazë të vendndodhjeve të sakta të realizimit të projektit.	Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e kontraktimit të projekteve kapitale për punë të përdor procedurën e duhur të prokurimit, të kontraktohen me paramasë dhe parallogari të sasive të planifikuara në mbështetje të projektit kryesor.	Për zbatimin e këtij rekomandimi, janë njoftuar dhe udhëzuar zyrtarët e njësive kërkuese dhe zyrtarët e prokurimit që, gjatë fazës së planifikimit dhe inicimit të projekteve kapitale/ punë, të përcaktojnë dhe zbatojnë llojin e kontratës dhe procedurën e prokurimit në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit për prokurimin publik. Është forcuar sistemi i kontrollit të brendshëm në fazën e përgatitjes së dosjeve të tenderit, me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së llojit të kontratës me natyrën dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Për më tepër, të gjitha dosjet e tenderit për projekte kapitale do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak nga Zyra e Prokurimit dhe menaxhmenti përgjegjës para publikimit, me qëllim të parandalimit të përdorimit të procedurave ose llojeve të kontratave që nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.	Njësia e kërkesës, zyrtarët e prokurimit, Udhëheqësi i prokurimit	31.12.2026
7	Çështja A4 - Mungesë e dokumentacionit financiar për urdhrat përmbartimor të ekzekutuar	Në auditimin e lëndëve të shpenzimeve gjyqësore në kategoritë ekonomike të ekzekutuara në bazë të listës së urdhrave përmbartimor nga thesari për personat juridik dhe fizik, në 30 mostra të urdhrave përmbartimor të ekzekutuar në vlerë totale 3,884,852€, nuk na është ofruar dokumentacioni financiar mbështetës (Propozimet urdhërat përmbartimor, faturat, raportet e pranimit – situacioneve të punëve, shërbimeve të kryera dhe kontratat).	Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e propozim përmbartimor nga përmbartuesi, që lenda është e mbuluar me dokumentacionin e plotë mbështetës financiar dhe gjatë procesit të auditimit të ju ofrohet i gjithë dokumentacioni i kërkuar auditorëve.	Menaxhmenti ka ndërmarrë masa për forcimin e kontrollit të brendshëm lidhur me dokumentacionin që lidhet me urdhrat përmbartimorë, duke shtuar kontrollet e brendshme për verifikimin e pranimit dhe përcjelljes së dokumentacionit në njësitet përkatëse organizative. Menaxhmenti ka identifikuar se mangësitë kryesore kanë të bëjnë me arkivimin jo të duhur të dokumentacionit nëpër drejtori, prandaj ka obliguar drejtoritë përgjegjëse që të sigurojnë sistemin dhe ruajtjen e plotë të dokumenteve financiare dhe ligjore në dosje të veçanta për secilin rast.	Drejtorët e Drejtorive, Menaxherët e kontratave, zyrtarët financiar të Drejtorive	Në vazhdimësi gjatë vitit 2026
8	Çështja B4 - Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare	Kontrata "Renovimi i bibliotekës ndërkomunale në Prizren" në vlerë të kontraktuar 1,488,938€ është kontratë pune investim kapital e e cila nuk është e paraparë në buxhet e kategorisë së investimeve kapitale; Kontrata "Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave në zonën e parë të objekteve të mbrojtura, kryesisht në pjesën e vjetër të qytetit të Prizrenit" në vlerë të kontraktuar 3,000,000€ me çmim për njësi 3,412.33€ ndërsa në PIP ka pasur mjete në vlerë 2,450,631€ nga kjo rezultojnë në mungesë të fondeve për realizimin e projektit në vlerë 549,369€;	Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë në përputhje me shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.	DKRS- Lidhur me të gjeturën, "Renovimi i bibliotekës ndërkomunale në Prizren", në qarkoren e dytë buxhetore për KAB 2027-2029, ky projekt do të përfshihet në planifikim të kategorisë buxhetore Investime Kapitale për pjesën e mbetur të realizimit të kësaj kontrate. Drejtoria e Shërbimeve Publike e ka marrë në konsideratë rekomandimin dhe gjatë planifikimit buxhetor për periudhën 2027-2029 do të sigurojë mjete buxhetore në përputhje me planin dinamik të zbatimit të kontratës "Rehabilitimi dhe revitalizimi i	Udhëheqësit/ zyrtarët nga njësitet kërkuese, ZKF, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit	Shtator 2026 31.12.2026

				hapësirave publike". Për këtë projekt, nga mjetet e bartura nga viti 2025 janë siguruar rreth 500,000 €, të cilat kontribuojnë në mbulimin e nevojave financiare për zbatimin e kontratës. Kontraktimi i kontratave tjera të lidhura gjatë vitit 2026 është duke u bazuar në harmoni me LMFPF dhe ligjin e buxhetit duke ngrit zotimet/obligimet shumevjeqare të ndërlidhura me sistemit SIMFK dhe e-prokurimit.		Zbatimi i rekomandimit për kontrata e lidhura gjatë vitit 2026 ka filluar pas miratimit të buxhetit për vitin 2026.
9	Çështja B5 - Vonesa në pagesën e faturave	Në 19 raste, faturat në total prej 1,294,286€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave ishin nga një (1) deri 516 ditë kalendarike.	Rekomandimi B5 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Vonesat në ekzekutimin e pagesave gjatë vitit 2025 nuk kanë qenë rezultat i planifikimit jo adekuat të buxhetit. Këto vonesa kanë ardhur si pasojë e ekzekutimit të pagesave nga Thesari në bazë të vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore. Gjatë vitit 2025, nga buxheti komunal janë ekzekutuar mbi 12 milionë euro për obligime që rrjedhin nga vendimet përmbartimore dhe gjyqësore, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në dinamikën e realizimit të pagesave të planifikuara. Është forcuar koordinimi ndërmjet njësive kërkuese, Zyrës së Financave dhe Zyrtarit Kryesor Financiar, me qëllim që faturat e pranuar të procedohen pa vonesa dhe të planifikohet me kohë sigurimi i mjeteve për pagesën e tyre. Përjashtimisht janë pagesat përmes procedurave përmbartimore, të cilat pagesa janë jashtë kontrollit të Komunes, sepse po ekzekutohen nga thesari.	Menaxherët e kontratave, Zyrtari Kryesor Financiar, zyrtarët e thesarit	Në vazhdimësi gjatë vitit 2026
10	Çështja A5 - Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik	Komuna ende nuk e ka hartuar rregulloren për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, si parakusht për harmonizimin e kontratave të punës me kuadrin e ri ligjor. Nga 70 kontrata të testuara, në 25 raste kontratat nuk ishin të azhurnuara sa i përket koeficienteve dhe elementeve tjera të përcaktuara me Ligjin për zyrtarët publik	Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr veprime miratimit e rregullores për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, me qëllim mundësimin e azhurnimit të kontratave të punës në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publik.	Komuna e Prizrenit, përmes Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ka ndërmarr veprime konkrete për hartimin dhe finalizimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës. Në kuadër të këtij procesi, Komuna ka nënshkruar kontratë me nr. 622-26-2071-2-2-1/C1774 për angazhimin e një eksperti individual për hartimin e rregullores, ndërsa procesi i përgatitjes së saj është në fazën përfundimtare. Mostrat e marra për shërbyesit civil kanë qenë në përputhje me Legjislacionin në fuqi. Drejtorja e Arsimit do të na ofroj të gjitha të dhënat sipas të gjeturave nga ZKA për kontratat në arsim.	Përgjegjës për Rregulloren e sistematizimit dhe klasifikimin e vendeve të punës Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore Drejtorja e Arsimit, si dhe Njësia për Menaxhimin e	Finalizimi i rregullores 30 nëntor 2026 Azhurmimi i kontratave në DKA 30 shtator 2026

				Lidhur me mostrat në arsim të cilat janë theksuar në të gjeturat, ne si Njësi e Burimeve Njerëzore këtë rekomandim do të zbatojmë në tërësi. Drejtoria e Shëndetësisë do të na ofroj të gjitha të dhënat sipas të gjeturave nga ZKA për kontratat në shëndetësi. Lidhur me mostrat në shëndetësi të cilat janë theksuar në të gjeturat, ne si Njësi e Burimeve Njerëzore, këtë rekomandim do të zbatojmë në tërësi.	Burimeve Njerëzore Drejtoria e Shëndetësisë, si dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Azhurmimi i kontratave në Drejtorinë e Shëndetësisë 31.07.2026
11	Çështja A6 Paqartësi në kërkesat e shpalljes së tenderit për blerjen e dy autoambulancave	Në kontratën për "Furnizim me dy autoambulanca për nevojat e shëndetësisë primare" në vlerë 139,450€, Komuna bazuar në kërkesat e parapara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit kishte vendosur kërkesat të paqarta-kundërta, ku në njërin anë nuk ka lejuar variantet përkatësisht modifikimin ndërsa të kërkesat e kapacitetit teknik profesional ka kërkuar atest të konvertimit të veturës në autoambulancë.	Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë dhe të kërkojë nga zyrtaret përgjegjës të prokurimit që me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit të përfshijë të gjitha kërkesat e qarta dhe të detajuara duke kontribuar në një proces të prokurimit me të rregullte dhe në interes të komunës dhe interesit publik.	Janë ndërmarrë masa konkrete për adresimin e gjetjes, duke përfurcuar kontrollin e brendshëm në procesin e përgatitjes së dosjeve të tenderit. Është vendosur rishikimi paraprak i dokumentacionit të tenderit nga zyrtarët përgjegjës, me qëllim të sigurimit të qartësisë dhe harmonizimit të të gjitha kërkesave teknike dhe profesionale. Është përmirësuar koordinimi ndërmjet njësive kërkuese dhe zyrës së prokurimit, ndërsa stafi përgjegjës është udhëzuar që në të ardhmen të shmangë vendosjen e kërkesave të paqarta ose kundërtënësë, me qëllim zhvillimin e procedurave të rregullta dhe në interes të komunës dhe interesit publik.	Udhëheqësi i prokurimit dhe zyrtarët e prokurimit	Ky rekomandim ka filluar të zbatohet dhe e njëjta nuk do të përsëritet.
12	Çështja B6 - Mungesë e informatave të plota për menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike	Menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar me informata të plota menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performances së kontraktuesve në modulën përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik	Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë të dhënat e plota për menaxhimin e kontratave në modulën përkatës në sistemin e prokurimit publik.	Përkundër faktit që disa nga menaxherët kontratave kanë futur dokumentacionin e nevojshëm dhe menaxhimi i kontratave përmes platformës e-prokurimi, menaxhmenti do të insiston që kjo platformë të përdoret nga të gjithë menaxherët e kontratave aktive publike. Trajnim për të gjithë menaxherët e kontratave mbi E-prokurimin	Menaxherët e kontratave në të gjitha drejtorite ku nuk përdorin modulën e-prokurimi	Në vazhdimësi deri më 31.12.2026
13	Çështja B7 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare	Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare duke mos përfshirë të gjitha drejtoritë e komunës (arsimin dhe shëndetësin) në raportin e inventarizimit, tutje nuk kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive me regjistrat kontabël rrjedhimisht nuk dihet diferencat në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare që kanë të bëjnë me vlerësimin e pasurive të dëmtuara, vlerësimin e kërkesave për tjetërsim të pasurive si dhe përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi.	Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit, regjistrimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale sipas klasifikimit kontabël.	Menaxhmenti do të ndërmarrë masa për përmirësimin e procesit të inventarizimit, regjistrimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare në përputhje me kërkesat e Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore. Përmes Drejtoritë të financave, ZKF dhe zyrtarëve të pasurisë, anëtarët e komisionit të inventarizimit do të udhëzohen që në raportin përfundimtar për inventarizimin në vitin 2026 të përfshijnë të gjitha raportet e inventarizimit të të gjitha drejtorive dhe njësive organizative të komunës, përfshirë institucionet e arsimit dhe shëndetësisë. Do të themelohet me kohë Komisioni për vlerësimin e pasurisë i cili do të do të kryejnë vlerësimin e pasurive të dëmtuara dhe të	Drejtori i financave, ZKF, zyrtari i pasurisë dhe anëtarët e Komisionit të Inventarizimit Drejtori i Financave	15 janar 2027

				papërdorshme, do të shqyrtojnë kërkesat për tjetërsimin e pasurive dhe do të përgatisin raporte të veçanta për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi. Po ashtu, pas përfundimit të inventarizimit dhe raportit përfundimtar nga komisioni i vleresimit, të bëhet krahasimi i plotë i gjendjes fizike të pasurive me regjistrat kontabël dhe regjistrin e pasurive, ndërsa të gjitha dallimet e identifikuar të analizohen, dokumentohen dhe trajtohen me veprime korrigjuese përkatëse.	dhe Kryetari i Komunës Komisioni i inventarizimit dhe zyrtari i pasurisë	30 nëntor 2026 16-30 janar 2027
14	Cështja B8 - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme	Në vitin 2025, totali i llogarive të arkëtueshme të komunës arriti në 29,217,478€, duke shënuar një rritje nga viti paraprak për 1,928,313€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë (51%), taksës nga mbeturinat (23%), taksës për leje ndërtimi (14%), taksës për bizneset (9%) dhe qirasë për shfrytëzimin e pronës publike (3%). Në bazë të testimit kemi vërejtur se në 25 raste komuna nuk kishte marrë masa të nevojshme për mbledhjen e borxheve ndonëse afati për inkasim ishte tejkaluar.	Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.	Drejtoria e Tatimit në Pronë: Është planifikuar inicimi i procedurës së prokurimit për identifikimin dhe verifikimin e pronave të reja, si dhe verifikimin e të dhënave të pronave ekzistuese në Komunën e Prizrenit. Qëllimi i këtij aktiviteti është zgjerimi i bazës tatimore dhe rritja e inkasimit të të hyrave komunale. Po ashtu, në kuadër të këtij procesi do të ndërmerren edhe veprime për trajtimin e llogarive të arkëtueshme, në përputhje me procedurat për mbledhjen e Tatimit në Pronë të përcaktuara me Ligjin për Tatimin në Pronë. Drejtoria e financave- taksa për biznese: Lidhur me obligimet që rrjedhin nga taksat e bizneseve, do të shqyrtohen të gjitha mundësitë dhe procedurat ligjore në dispozicion, me qëllim që këto obligime të trajtohen dhe, sipas nevojës, të shlyhen në përputhje me vendimet e Kuvendit Komunal dhe legjislacionin në fuqi. Drejtoria e Sherbimeve Publike- taksa nga mbeturina: Është iniciuar procedurat për angazhimin e mbështetjes së nevojshme kontraktuale me qëllim identifikimin e debitorëve dhe fillimin e procedurave përmbartimore për arkëtimin e borxheve nga taksa e mbeturinave. Aranzhimi i task-forcës, do të kontribuojë në përmirësimin e procesit të arkëtimit dhe do të lehtësojë në masë të konsiderueshme grumbullimin e llogarive të arkëtueshme. Drejtoria e Urbanizmit: Njoftimi dhe dërgimi i vërejtjeve ndaj investitorëve që nuk kanë përmbushur obligimet e tyre financiare brenda afateve të përcaktuara; Në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve edhe pas vërejtjeve, do të ndërmerren	Drejtoesha, menaxheri i Drejtorisë së Tatimit në Pronë, Drejtori për ekonomi dhe financa dhe zyrtrët e të hyrave për taksa nga bizneset, Udheheqësi dhe zyrtarët përgjegjës të Sektorit të Ambientit, Drejtori dhe zyrtari përgjegjës i caktuar i Drejtorisë së Pronës, Drejtori dhe zyrtarët përgjegjës sipas lëndeve në Drejtorinë Urbanizmit	Drejtoria e Tatimit në Pronë: Zbatimi i rekomandimit nuk mund të realizohet në tërësi brenda vitit 2026, pasi paraqet proces të vazhdueshëm. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa – Taksa për Biznese: Zbatimi i rekomandimit është proces i vazhdueshëm dhe nuk mund të përmbyllet brenda vitit 2026 Drejtoria e Sherbimeve Publike- taksa nga mbeturina: Zbatimi i rekomandimit do të fillojë nga viti 2027 Drejtoria e Urbanizmit: Korrik – Dhjetor 2026 Drejtoria e Pronës: Korrik – Dhjetor 2026

				procedurat ligjore përkatëse për realizimin e arkëtimit të borxheve. Drejtoria e Pronës: 1. Vizita të rregullta mujore tek shfrytëzuesit e pronës komunale (dorëzimi i fletëpagesave mujore për muajin pasues dhe tërheqja e dëshmisë së pagesës sipas orarit të pagesave). 2. Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me Drejtorinë e Financave lidhur me: Raportimi në baza mujore të pagesave nga shfrytëzimi i pronave komunale nga ana e Drejtorisë së Financave. Rregullimi i paagesave të realizuara por të pa identifikuar nga DF si rezultat i gabimeve të shkaktuara gjatë pagesave dhe identifikimi i tyre në llogaritë relevante brenda DF. 3. Përgatitja e formave Njoftim/Vërejtje për rastet e mos zbatimit të rregullt të pagesave mujore. 4. Njoftime të rregullta për pasojat e mos zbatimit të orarit të pagesave nga shfrytëzuesit e pronave komunale		
--	--	--	--	---	--	--

Kryetari i Komunës

Shaqir Totaj

